



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, parashtron këtë:

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 4 dhe 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës 15Nr.110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2024 të miratojë këtë

PROPOZIM

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR FERMERË PËR SUBVENCIONIMIN E QUMËSHTIT

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare në shumë prej **32,111.00**, (tridhjetë e dy mijë e njëqind e njëmbëdhjetë euro) për subvencionimin e qumështit për litër për 46 (katërdhjetë e gjashtë) fermerë të Komunës së Lipjanit me 0.04 cent për litër konform Rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve për subvencionimin e qumështit Nr.15-320/01-15232 i datës 18.03.2024.

Neni 2

Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikura për vitin 2024 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, kodi i programit 47003, fondi burimor 21/613/47003/200/00000/0421.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës dhe Rregullores për ndarjen e subvencioneve .

Qëllimi i miratimit të këtij Propozim - Vendimi është subvencionimi i qumështit për litër për 46 (katërdhjetë e gjashtë) fermerë të Komunës së Lipjanit me 0.04 cent për litër konform Rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve për subvencionimin e qumështit Nr.15-320/01-15232 të datës 18.03.2024.

Kryetari i Komunës në pajtim me nenet 4 dhe 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 dhe Rregullores së Kuvendit të Komunës 15Nr.110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 për të marrë Vendim për ndarjen e mjeteve financiare kërkon nga Kuvendi i Komunës dhënien e Pëlqimit për ndarjen e shumës së propozuar në nenin 1 të këtij Propozim Vendimi .

1Nr. 400/01-15461

Lipjan, më 19.03.2024

KRYETARI KOMUNËS

Imri Ahmeti

